

Këshilli i Evropës

Konventa Evropiane
për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

TË DREJTAT DHE LIRITË NË PRAKTIKË

Burime të vlefshme për Mësuesit



Të drejtat e njeriut: në qendër të fokusit të këshillit të evropës



Këshilli i Evropës: organizatë unike në llojin e vet

Objektivat kryesore të Këshillit të Evropës janë:

- ◆ të mbrojnë të drejtat e njeriut, demokracinë pluraliste dhe shtetin e së drejtës
- ◆ të promovojë ndërgjegjësimin dhe të nxisë zhvillimin e identitetit dhe diversitetit kulturor të Evropës
- ◆ të gjejë zgjidhje të përbashkëta kundrejt sfidave me të cilat përballlet shoqëria evropiane: diskriminimi ndaj pakicave, ksenofobia, intoleranca, bioetika dhe klonimi, terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore, krimi i organizuar dhe korrupsioni, krimi kompjuterik dhe dhuna ndaj fëmijëve
- ◆ të konsolidojë stabilitetin demokratik në Evropë duke vënë në zbatim reforma politike, legjislativë e kushtetuese.

Me qëllim që të përmbushë këto objektiva, Këshilli i Evropës ka ngritur strukturat – organet e mëposhtme:

- ◆ **Komitetin e Ministrave:** organi vendim-marrës i përbërë nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare, ose përfaqësuesit e tyre të përhershëm në Strasburg
- ◆ **Asamblenë Parlamentare (PACE):** institucion i pavarur, anëtarët e të cilit caktohen nga parlamentet kombëtare të vendeve anëtare. Asambleja ka 318 anëtarë dhe 318 zëvendësues të tyre
- ◆ **Kongresin e Autoriteteve Lokale e Rajonale:** organ këshillimor që përfaqëson autoritetet lokale e rajonale
- ◆ **Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut:** organi gjyqësor që garanton të drejtat e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për cilindo nën juridiksionin e saj

- ◆ **Komisionerin për të Drejtat e Njeriut:** një zyrtar i pavarur roli i të cilit është të promovojë edukimin, ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në vendet anëtare
- ◆ **Konferencën e OJQ-ve Ndërkombëtare:** Këshilli i Evropës është i hapur për dialog me mbi 400 organizata ndërkombëtare jo-qeveritare (INGO), të cilat kanë fituar statusin si pjesëmarrës
- ◆ **Sekretarin e Përgjithshëm,** i zgjedhur si kreu i organizatës nga PACE me mandat pesë-vjeçar, është përgjegjës për planifikimin strategjik dhe drejtimin e programit të punës së Këshillit dhe buxhetit dhe mbikqyr menaxhimin e përditshëm të Organizatës
- ◆ **Sekretariatit:** mbi 2,000 anëtarë të personelit nga të 47 vendet anëtare punojnë në selinë e Këshillit në Strasburg (Francë) ose në zyrat e tyre në Evropë.

www.coe.int



Të drejtat e njeriut: në qendër të fokusit të këshillit të evropës

Një Evropë e Zgjeruar

Nga Rejkjaviku në Vladivostok

Themeluar në vitin 1949 nga 10 vende, Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare me seli në Strasburg (Francë).

Sot Këshilli ka 47 vende anëtare, duke përfaqësuar kështu 800 milion evropianë.

Anëtarët Themelues (5 maj 1949)

-  Belgjika
-  Danimarka
-  Franca
-  Irlanda
-  Italia
-  Luksemburgu
-  Norvegjia
-  Holanda
-  Mbretëria e Bashkuar
-  Suedia

Vende të tjera anëtare (sipas rendit të aderimit të tyre në Këshill)

-  Greqia (1949)
-  Turqia (1949)
-  Islanda (1950)
-  Gjermania (1950)
-  Austria (1956)
-  Qipro (1961)
-  Zvicra (1963)
-  Malta (1965)
-  Portugalia (1976)
-  Spanja (1977)
-  Lihtenshtejini (1978)
-  San Marino (1988)
-  Finlanda (1989)
-  Hungaria (1990)
-  Polonia (1991)
-  Bullgaria (1992)
-  Estonia (1993)
-  Lituania (1993)
-  Sllovenia (1993)
-  Republika Çeke (1993)
-  Sllovakia (1993)
-  Rumania (1993)
-  Andora (1994)
-  Letonia (1995)
-  Shqipëria (1995)
-  Moldavia (1995)
-  "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" (1995)
-  Ukraina (1995)
-  Federata Ruse (1996)
-  Kroacia (1996)
-  Gjeorgjia (1999)
-  Armenia (2001)
-  Azerbajxhani (2001)
-  Bosnja dhe Hercegovina (2002)
-  Serbia (2003)
-  Monako (2004)
-  Mali i Zi (2007)



A E Dinit ?

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është bazuar drejtpërdrejt në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, adoptuar – miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948.

Çfarë Përfaqëson KEDNJ?

Garantimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një **traktat ndërkombëtar** miratuar në 1950 i cili hyri në fuqi në vitin 1953. Përfaqëson konventën e parë të Këshillit të Evropës që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shtetet duhet të ratifikojnë Konventën për tu bërë pjesë e Organizatës.

Që nga viti 1950 Konventa i është nënshtruar disa ndryshimeve – amendimeve dhe i ka dhënë shtysë krijimit të shumë konventave të tjera të Këshillit të Evropës. Ajo është e përbërë nga një numër nenesh, të shtuara me kalimin e viteve nga protokolle duke shtuar të tjera të drejta në Konventë. Jurisprudenca e Gjykatës e shndërron Konventën në një "instrument të gjallë", në gjendje për t'iu përshtatur ndryshimeve që ndodhin në shoqëritë tona.

Konventa mbron të drejtat për:

- ◆ jetën, lirinë dhe sigurinë
- ◆ respektimin e jetën private e të familjes
- ◆ lirinë e shprehjes
- ◆ lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë
- ◆ të votuar e kandiduar në zgjedhje elektorale
- ◆ një gjykim të drejtë në çështje civile e penale
- ◆ pronën e gëzimin paqësisht të pronave.

Ndërmjet të tjerave, ajo ndalon:

- ◆ torturën ose trajtimin çnjerëzor e degradues apo ndëshkimin
- ◆ skllavërinë dhe punën e detyruar
- ◆ ndalimin arbitrar e të paligjshëm
- ◆ diskriminimin në gëzimin e të drejtave e lirive të siguruara nga Konventa
- ◆ dëbimin e nënshtetasve nga shteti i tyre apo mohimin ndaj tyre për të hyrë në atdhe
- ◆ dënimin me vdekje
- ◆ dëbimin kolektiv të të huajve.



Koncepte Kyçe

Traktat ndërkombëtar
Marrëveshje ndërmjet shteteve me qëllim prodhimin e efekteve ligjore në marrëdhëniet e tyre reciproke.

Konventë
Konventa është një marrëveshje ligjore ndërmjet dy apo më shumë shtetesh. Shtetet ftohen së pari të nënshkruajnë konventën duke treguar se kanë vullentin të ndjekin ç'parashikon ajo, e më pas, kur janë të sigurt se janë në gjendje t'i përmbushin parashikimet në të, e ratifikojnë atë – e kjo nënkupton që ata angazhohen të përmbushin vlerat dhe udhëzimet që përmban Konventa.

Protokoll i Konventës
Një protokoll i Konventës është një dokument që shton një ose më shumë të drejta në Konventën origjinale, ose ndryshon disa nga dispozitat e saj. Protokollat që i shtojnë të drejta Konventës janë detyruese vetëm për ato shtete që i kanë nënshkruar e ratifikuar ato. Deri më sot janë adoptuar – miratuar 14 protokolle shtesë të KEDNJ-së.

www.human-rights-convention.org



A e dinit?

Evropa nuk është i vetmi kontinent që ka një gjykatë që mbron të drejtat e njeriut. Ka edhe dy gjykata të tjera rajonale: Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Afrikane për të Drejtat Humane e të Njeriut. Në vitin 2008, për të celebruar 60 vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të tre gjykatat u mbledhën së bashku në një seminar në Strasburg. Në fjalën e tij, Jean-Paul Costa, Presidenti i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, tha: "Nuk do të kishte besoj mënyrë më të mirë për të demonstruar qëllimin universal të të drejtave të njeriut"

Roli i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Garantimi i demokracisë e shtetit të së drejtës

E krijuar në vitin 1959, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është organi gjyqësor që garanton të drejtat e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për këdo që ndodhet nën juridiksionin e një shteti kontraktues. Që nga 1 nëntori 1998 kemi një Gjykatë të vetme me seli të përhershme në Strasburg (Francë).

Numri i gjyqtarëve të Gjykatës është i njëjtë me atë të Shteteve Palë të Konventës. Gjyqtarët janë tërësisht të pavarur, nuk përfaqësojnë vendin e tyre dhe zgjidhen nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Në të 50 vitet e funksionimit të saj, Gjykata ka nxjerrë më shumë se 10,000 gjykime. Këto gjykime janë detyruese për shtetet e përfshira në çështje dhe u kërkojnë atyre të rregullojnë pasojat e cënimeve për aplikuesit dhe të amendojnë legjisllacionin e tyre e praktikën në fusha të ndryshme, nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave. Konventa është rritur nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës si një instrument jetësor për të përballur sfidat e reja dhe si një forcë për konsolidimin e shtetit ligjor e demokracisë në mbarë Evropën.

Për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të **çështjeve** që paraqiten para Gjykatës, tashmë po bëhen disa reforma në këtë kuadër. Në qershor 2010 nisi një proces i gjerë reformues për të siguruar efektivitetin e Gjykatës.



Koncepte kyçe

Gjykim

Vendimi që jepet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përse i përket themelit të çështjes, ose me fjalë të tjera, ankimimit në fjalë. Gjykimi nuk duhet ngatërruar me një ...

... Vendim

Një vendim i Gjykatës lidhet me pranueshmërinë e një ankimi. Kjo ndodh kur Gjykata verifikon se janë përmbushur të gjitha kërkesat.

Kërkesë ose çështje

Mosmarrëveshje që zgjidhet nga një gjykatë.

Ankimim

Arsyeja e aplikimit me një çështje. Ankimimet shqyrtohen kur Gjykata trajton themelin e një kërkesë.

E papranueshme

Kur një kërkesë është e pabazë apo nuk ka baza të mjaftueshme deklarohet si e papranueshme dhe rrezohet nga Gjykata.



A e dinit?

Kërkuesit nuk janë të detyruar të paraqesin kërkesën e tyre në një nga dy gjuhët zyrtare të Gjykatës (anglisht dhe frëngjisht); ata mund ta paraqesin atë në cilëndo gjuhë zyrtare të vendit të tyre që ka ratifikuar Konventën. Seancat bëhen në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Ato janë publike me përjashtim kur vendoset ndryshe nga Presidenti i Dhomës së Madhe, sipas rastit.

Paraqitja e një Kërkese

Kushtet që duhen Përmbushur

Kush mund të paraqesë një çështje para Gjykatës?

Çështjet mund të paraqiten direkt nëpërmjet kërkesave individuale apo nga disa shtete që besojnë se u janë cënuar të drejtat e tyre. Kështu, Konventa bën dallimin ndërmjet dy lloje **kërkesash**:

- ◆ kërkesa individuale, që parashtrohen përpara gjykatës nga një individ, grup individësh, apo organizatë jo-qeveritare (OJQ) kundër një apo më shumë shtetesh;
- ◆ kërkesa ndërshtetërore që paraqiten nga një shtet kundër një tjetri.

Që me krijimin e Gjykatës, gati të gjithë kërkesat janë paraqitur nga individë.

Kushtet formale

Gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë nëse kërkesa është e **pranueshme**. Kërkesa duhet të plotësojë disa kushte të caktuara të parashtuara në Konventë për tu konsideruar si e pranueshme. Për shembull, kërkuesit duhet të provojnë se i kanë "shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore" (në përgjithësi kjo nënkupton që gjykata më e lartë në vendin e tyre e ka rrëzuar ankimmimin e tyre) dhe ata duhet të paraqesin kërkesën e tyre brenda gjashtë muajve nga vendimi përfundimtar i marrë në vendin e tyre.

Nëse kërkesa konsiderohet e pranueshme, Gjykata nxit palët (kërkuesin dhe shtetin e përfshirë në çështje) të arrijnë një zgjidhje me pajtim. Për shembull, një shtet mund të bjerë dakord të paguajë kompensim, dhe kërkesa tërhiqet. Nëse nuk arrihet **zgjidhje me pajtim**, Gjykata në vijim shqyrton themelin e çështjes, pra konsideron nëse ka pasur apo jo shkelje të të drejtave të Konventës.



Koncepte Kyçe

Kërkesë/kërkuesi

Konventa bën dallimin ndërmjet dy lloje kërkesash: kërkesa individuale (paraqitur nga një individ, grup individësh, kompani apo OJQ) dhe kërkesa ndërshtetërore (që paraqiten nga një Shtet kundër një tjetri).

Pranueshmëria

Një kërkesë duhet të plotësojë disa kritere (psh, shterrimin e të gjitha mjeteve të brendshme ligjore, duhet të paraqitet brenda gjashtë muajve, duhet t'i referohet një shkeljeje që mbrohet nga KEDNJ), në të kundërt do të deklarohet si e papranueshme nga Gjykata, pa vijuar me shqyrtimin e ankimmimit.

Zgjidhja me Pajtim

Kjo është marrëveshja ndërmjet palëve që rrjedhimisht i jep fund vijimit të kërkesës, nëse Gjykata e konsideron se interesi i të drejtave të njeriut nuk është i mjaftueshëm që të bëjë që çështja të shqyrtohet. Kur kërkuesi dhe shteti në fjalë bien dakord që të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre në këtë mënyrë, rezultati zakonisht është që shteti i paguan kërkuesit një shumë parash.



3

Si funksionon Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Kohëzgjatja e një Kërkese

Tabela e Kohëzgjatjes së Procesimit të një Çështjeje

A e dinit?


Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës nga një listë prej tre kandidatësh të propozuar nga çdo shtet. Ata zgjidhen për një mandat të parinovueshëm prej nëntë vitesh.

Koncepte Kyçe

Dhoma e Madhe
Kjo Dhomë është formacioni i zgjeruar i përbërë prej 17 gjyqtarësh. Dhoma e Madhe shqyrton një çështje në apelim apo çështje që ngrenë për shqyrtim cënim të rëndë të të drejtave të njeriut.

Shpërblim i drejtë – dëme ekonomike – dëme joekonomike
Kur Gjykata konstaton kundrejt një Shteti dhe vëzhgon se kërkuesit i janë shkaktuar dëme, mund t'i japë atij apo asaj shpërblim të drejtë, dmth, një shumë parash për të kompensuar atë dëm.

Dëmi mund të jetë "ekonomik" (humbje të pronës apo burimit të të ardhurave) ose "joekonomik" (vuajtje, mosrespektim të dinjitetit të individit, etj...)





A e dinit?

Ekzekutimi i një vendimi vijon të mbetet nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave derisa të plotësohen rezultatet e pritura. Komiteti i Ministrave merr pjesë aktive në gjetjen e zgjidhjeve duke ofruar përkrahje, asistencë, ose nëse nevojitet, edhe duke ushtruar presion. Kur Komiteti konsideron se vendimi është ekzekutuar plotësisht, ai adopton publikisht një "Rezolutë Finale" ku parashtron në detaj masat e marra.

Çfarë ndodh pasi Gjykata jep Gjykimin?

Ekzekutimi dhe Impakti i Gjyimit

Vendimet e Gjykatës janë detyruese: kur konstatojnë një shkelje, vendi në fjalë është i detyruar të ekzekutojë vendimin, duke marrë masa për të siguruar që një shkelje e tillë e ngjashme të mos ndodhë më e të rregullojë pasojat për viktimën. Gjykata gjithashtu mund të urdhërojë shtetin t'i paguajë kërkuarit një shumë parash si "shpërblim të drejtë", si kompensim. Të tjera masa specifike mund të nevojiten gjithashtu, si për shembull, lirimi i kërkuarit nëse mbahet nën arrest, rivendosja e kontakteve me fëmijën e kërkuarit, dhënie e lejes së qëndrimit për të, etj.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës: ndihmon shtetet që të identifikojnë masat e nevojshme e të gjendet zgjidhje kur adoptimi i masave të caktuara ndeshet me probleme. Gjithashtu, ai vlerëson efektivitetin e masave të marra për kërkuarin dhe për këdo tjetër që mund të gjendet në të njëjtën situatë.

Shembuj të masave të përgjithshme të marra nga shtetet në vijim të vendimit të marrë nga Gjykata :

- ◆ **Austria** i dha fund monopolit që zbatohet për televizionin
- ◆ **Belgjika** amendoi ligjet për të pastrehët dhe adoptoi masa për të ndaluar çdo lloj diskriminimi kundrejt fëmijëve të lindur jashtë martesë
- ◆ **Bullgaria** krijoi një shërbim ushtarak alternativ për ankimuesit
- ◆ **Kroacia** paraqiti një zgjidhje efektive kundrejt kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore
- ◆ **Republika Çeke** kaloi një ligj të ri mbi falimentimin
- ◆ **Danimarka** e zgjeroi të drejtën për të mos qenë pjesë e një sindikate
- ◆ **Finlanda** amendoi ligjin për kujdestarinë e fëmijës dhe të drejtat për vizita

- ◆ **Franca, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar** kaluan ligjet mbi përgjimet telefonike
- ◆ **Gjermania** u dha personazheve të famshëm një të drejtë më të madhe për të mos botuar fotot e tyre private
- ◆ **Greçia** përmirësoi kushtet e vendeve të ndalimit për të huajt në pritje të dëbimit
- ◆ **Hungaria** prezantoi vendim-marrje më të drejtë përsa i përket kohëzgjatjes së lirimit me kusht
- ◆ **Irlanda** hoqi penalizimin e akteve homoseksuale
- ◆ **Italia** bëri të detyrueshme për avokatët mbrojtës që të paraqiten para Gjykatës së Kasacionit
- ◆ **Letonia** hoqi testet gjuhësore diskriminuese për kandidatët në zgjedhje
- ◆ **Moldavia** njohu lirinë e fesë
- ◆ **Hollanda** amendoi legjislacionin për ndalimin e pacientëve me sëmundje mendore
- ◆ **Polonia** paraqiti një sistem efektiv kompensimi për persona të caktuar që ishin shpronësuar pas Luftës së Dytë Botërore
- ◆ **Rumania** hoqi dispozitat që mundësonin anulimin e vendimeve përfundimtare të gjykatës
- ◆ **Federata Ruse** përmirësoi sigurimin e përkujdesit social për viktimat e Çernobilit
- ◆ **Republika Sllovake** amendoi legjislacionin për mbajtjen e fëmijëve
- ◆ **Sllovenia** mori masa për parandalimin e keqtrajtimit nga policia
- ◆ **Suedia** amendoi dispozitat për gjykimet publike
- ◆ **Zvicra** rishikoi sistemin e gjykatës penale dhe procedurat penale
- ◆ **Turqia** hoqi prezencën e gjyqtarëve ushtarak në gjykatat shtetërore të sigurisë
- ◆ **Ukraina** amendoi legjislacionin mbi shpifjen
- ◆ **Mbretëria e Bashkuar** ndaloi ndëshkimin trupor në shkollë.



Shembuj të masave individuale marrë nga shtetet në vijim të një vendimi të Gjykatës:

- ◆ në **Azerbajxhan**, kërkuesi i cili ishte dëbuar gabimisht, u rikthye në atdhe
- ◆ në **Bosnjë dhe Hercegovinë**, kërkuetit iu rikthyen kursimet e veta
- ◆ në **Bullgari**, Prokurori i Përgjithshëm i Shtetit kërkoi rihapjen e një gjyqi, gjykuar si i padrejtë
- ◆ në **Kroaci**, një kërkuesi iu kthye pasaporta mbrapsht pasi ishte mbajtur nga autoritetet
- ◆ në **Qipro**, kërkuetit iu dha mundësia të mund të votonte
- ◆ në Republikën Çeke, kërkuesi fitoi pensionin pasi i ishte pezullar
- ◆ në **Finlandë**, prindërit mundën t'i japin emrin djalit të tyre sipas zgjedhjes së tyre, gjë që u ishte refuzuar nga autoritetet
- ◆ në **Gjeorgji**, kërkuesi i cili ishte mbajtur pa të drejtë nën arrest, u lirua
- ◆ në **Gjermani**, i ati i një fëmije të lindur jashtë kurore e abandonuar nga e ëma, iu dha kujdestaria
- ◆ në **Greqi**, kërkuetit mundën të hapnin një shkollë
- ◆ në **Hungari**, një historiani iu dha akses për dokumente të klasifikuara
- ◆ në **Letoni**, një kërkuesi i mbajtur në masë arresti në kushte të papërshtatshme për moshën e tij (84 vjeç), u lirua
- ◆ në **Lituani**, të dhënat në lidhje me kërkuetin u fshinë nga lista e të huajve të ndaluar për të qëndruar në vend
- ◆ në **Moldavi**, një kishë u njoh e u regjistrua
- ◆ në **Mal të Zi**, personi që kishte zënë në mënyrë të paligjshme apartamentin e kërkuetit, u dëbua
- ◆ në **Poloni**, dosja e dënimit të kërkuetit për shpifje u fshi nga regjistri
- ◆ në **Portugali**, një babai iu lejua përsëri të shohë të birin
- ◆ në **Rumani**, ish pronarët e pronave të shtetëzuara mundën të rifitonin pronat e tyre ose të merrnin kompensim
- ◆ në **Federatën Ruse**, një kërkuesi fitoi nënshtetësinë
- ◆ në **Republikën Sllovake**, një kërkuesi mundi të ndalonte një vendim atësie
- ◆ në **Zvicër**, një baba mundi të gjente fëmijën e tij që ishte marrë nga e ëma dhe ishte fshehur në Mozambik
- ◆ në **Turqi**, u hoqën ndalimet për aktivitetet politike të vendosura për anëtarët të partive të shpërbëra
- ◆ në **Mbretërinë e Bashkuar**, një kërkuesi iu njoh fakti se kishte qenë viktimë e testeve kimike gjatë shërbimit të tij ushtarak dhe si rezultat, përfitoi ngritje të pensionit.



Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Version i Thjeshtuar i disa neneve e protokolleve¹

Përmbledhje e Preambulës

Qeveritë Nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës punojnë për të siguruar paqen dhe një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tyre bazuar në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Me anë të Konventës ata vendosin të ndërmarrin hapat e parë drejt zbatimit të shumë të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

◆ Neni 1 – Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Shtetet i sigurojnë çdokujt të drejtat e përcaktuara në këtë Konventë.

◆ Neni 2 – E drejta për jetën

Ju gëzoni të drejtën për jetën.

◆ Neni 3 – Ndalimi i torturës

Askush nuk ka të drejtë t'ju lëndojë apo t'ju torturojë. Edhe nëse jeni nën arrest, dinjiteti juaj njerëzor duhet respektuar.

◆ Neni 4 – Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

Është e ndaluar që t'ju trajtojnë si skllav apo t'ju shtrëngojnë të kryeni punë me dhunë apo të detyruar.

◆ Neni 5 – E drejta për liri dhe siguri

Çdokush ka të drejtën e lirisë e sigurisë personale. Nëse arrestoheni ligjërisht, keni të drejtën për tu informuar mbi arsyet e arrestimit.

Nëse arrestoheni ligjërisht, keni të drejtën të gjykojeni brenda një afati të arsyeshëm, ose të liroheni derisa të fillojë gjyqi.

◆ Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia të provohet ligjërisht. Çdo person ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat i cili paguhet nga shteti nëse është i varfër.

◆ Neni 7 – Nuk ka dënim pa ligj

Askush nuk mund të dënohet për një krim nëse në çastin kur është kryer nuk përbënte vepër penale.

◆ Neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

Çdokush ka të drejtë që t'i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.

◆ Neni 9 – Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë. Çdokush ka të drejtën të shfaqë fenë e tij/saj në familje e në publik e të ndërrojë fenë nëse dëshiron.

◆ Neni 10 – Liria e shprehjes

Çdokush ka të drejtën që me përgjegjësi të shprehet e të shkruajë atë që mendon e të japë e marrë informacion nga të tjerë.

Kjo e drejtë gjithashtu mbulon lirinë e shtypit.

◆ **Neni 11 – Liria e tubimit dhe e organizimit**

Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit – duke përfshirë edhe sindikatat.

◆ **Neni 12 – E drejta për t'u martuar**

Çdokush ka të drejtën për t'u martuar e krijuar familje.

◆ **Neni 13 – E drejta për ankim efektiv**

Çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv zyrtarisht pranë gjykatave apo organeve të tjera publike.

◆ **Neni 14 – Ndalimi i diskriminimit**

Gëzimi i të drejtave duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si ngjyra, gjinia, gjuha, mendimi politik ose fetar, apo origjina.

◆ **Nenet 19 deri 51**

Këto nene shpjegojnë se si funksionon Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

◆ **Neni 34 – Kërkesat individuale**

Nëse janë cënuar të drejtat e parashtruara në Konventë në një nga vendet anëtare, së pari duhet të apelonit tek të gjitha instancat e autoriteteve kombëtare kompetente.

Nëse kjo gjë nuk arrihet e nuk u janë plotësuar kërkesat, më pas mund të apelonit direkt në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

◆ **Neni 52 – Hetimet e Sekretarit të Përgjithshëm**

Një qeveri e caktuar duhet të japë shpjegimet e duhura për mënyrën se si e drejta e saj e brendshme siguron zbatimin efektiv të të drejtave të Konventës, nëse Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës e kërkon këtë.

Protokollet e Konventës

◆ **Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – Mbrojta e pronës**

Çdo person ka të drejtën e pronës së tij/saj dhe të përdorë zotërimet e veta.

◆ **Neni 2 i Protokollit Nr 1 – E drejta për arsim**

Çdokush ka të drejtën të shkojë në shkollë që të arsimohet.

◆ **Neni 3 i Protokollit Nr. 1 – E drejta për zgjedhje të lira**

Çdokush ka të drejtën të zgjedhë qeverinë e vendit të vet me anë të votimit të fshehtë.

◆ **Neni 2 i Protokollit Nr. 4 – Liria e lëvizjes**

Kushdo që ndodhet në mënyrë të rregullt në territorin e një Shteti ka të drejtë të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

◆ **Neni 1 i Protokollit Nr. 6 – Shfuqizimi i dënimit me vdekje**

Dënimi me vdekje shfuqizohet.

◆ **Neni 2 i Protokollit Nr. 7 – E drejta për apelim në çështjet penale**

Cilido mund të apelojë në një instancë më të lartë gjyqësore nëse është dënuar për kryerjen e një krimi.

◆ **Neni 3 i Protokollit Nr. 7 – Kompensim në rast vendimi gjyqësor të gabuar**

Cilido ka të drejtën të kompensohet nëse është dënuar për kryerjen e një krimi dhe vërtetohet se është i pafajshëm.

◆ **Neni 1 i Protokollit Nr. 12 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit**

Askush nuk mund të diskriminohet nga autoritetet publike për arsye të bazuara, për shembull, në ngjyrën, gjininë, gjuhën, mendimin politik e fetar apo origjinën.

www.human-rights-convention.org

¹ Ky dokument është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Njësinë e Shtypit e të Marrëdhënieve me Publikun të Gjykatës si dhe të Njësisë së Informacionit e Mbështetjes dhe Botimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Ligjore. Versioni i thjeshtuar i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është hartuar vetëm për qëllime edukimi; botimi bazohet në versionin e thjeshtuar të Deklaratës Universale së të Drejtave të Njeriut përgatitur nga Amnesty International e të tjerë institucione. Tekstet e vetme ligjore e origjinale janë versionet në gjuhët angleze e franceze të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e Lirive Themelore e protokolleve të saj.



Neni 2 mbron të drejtën e çdokujt për jetën.

Përbën një nga nenet më të rëndësishme në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke qenë se pa të drejtën për jetën është e pamundur të gëzohen të drejtat e tjera të garantuara nga Konventa.

Neni 2 vendos një numër detyrimesh për shtetet:

- ◆ detyrimin për të mos marrë jetën e tjetrit qëllimisht
- ◆ detyrimin për të ndërmarrë hapat e duhura për të mbrojtur jetën e njeriut. Kjo parashikon nxjerrjen e ligjeve dhe ndëshkimeve penale për të shmangur që njerëzit të dëmtojnë të tjerët e të kryhen investigime të detajuara për shkaqet e vdekjeve.



Neni 2:

Ju gëzoni të drejtën për jetën.

E drejta për *Jetën*

NË PRAKTIKË, *e drejta për jetën përfshin...*

... **mbrojtjen e të burgosurve:** shtetet duhet të marrin masat e duhura për të mbrojtur jetën e personave në burgje.

Në vitin 2006 Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Neni 2 në çështjen *Renolde kundër Francës*. Hélène Renolde u ankimua se autoritetet franceze nuk kishin marrë masat e duhura për të mbrojtur jetën e vëllait të saj i cili ishte vetëvarur në korrik 2000 në qelinë e tij në Burgun Bois-d'Arcy, ku mbahej në paraburgim. Gjykata vëzhgoi, ndërmjet të tjerash, se duhen marrë masa të veçanta për të burgosurit që njihen se vuajnë nga shqetësime të rënda mendore e që përbëjnë rrezik për vetëvrasje.

... **mbrojtja kundrejt rreziqeve mjedisore:** shtetet duhet të marrin masat e duhura për të mbrojtur shëndetin e individëve dhe të ndalojë çdo lloj rreziku mjedisor.

Në vitin 2008 Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Neni 2 në çështjen *Budayeva dhe të tjerë kundër Rusisë*. Të gjashtë kërkuesit jetonin në qytetin e Tyrnauzit, që ndodhet në rajonin malor pranë malit Elbrus në Republikën e Kabardino-Balkariya (Rusi). Çdo vit që nga viti 1937 janë raportuar rrëshkitje dheu në atë zonë, veçanërisht gjatë verës. Çështja kishte të bënte me akuzat e kërkuesve se autoritetet ruse kishin dështuar t'i kushtonin vëmendje paralajmërimeve e të merrnin masa për këto fenomene kur një rrëshkitje masive shkatërroi Tyrnauzin në korrik July 2000, e ato nuk paralajmëruan popullatën, nuk kryen evakuim apo masa emergjente pas fatkeqësisë e as nuk nisën hetime përkatësisht.

Neni 3 i Konventës ndalon turturën e trajtimin çnjerëzor apo poshtëruës në të gjitha rrethanat, duke përfshirë edhe kontekstin e luftës ndërkombëtare kundër terrorizmit.

Shtetet kanë detyrimin për të paraqitur masa parandaluese, si për shembull ligje që vendosin mbi trajtimin në kundërshtim me Nenin 3 si vepër penale, e për të kryer investigime të tërësishme mbi pretendimet e ushtrimit të torturës apo keqtrajtimin.

Mbrojtja kundër torturës është një parim i njohur botërisht dhe nuk kundërshtohet në të drejtën ndërkombëtare; ka disa koncepta të posaçme në këtë fushë të hartuara nga Këshilli i Evropës (p.sh., Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Konventa për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore) dhe nga Kombet e Bashkuara.



Neni 3:

Askush nuk ka të drejtë t'ju lëndojë apo t'ju torturojë.

T Ndalimi i Torturës

NË PRAKTIKË, *ndalimi i torturës zbatohet, për shembull ndaj...*

... brutalitetit që ushtrohet nga policia gjatë marrjes në pyetje: teknikat e marrjes në pyetje që përdoren nga organet e zbatimit të ligjit duhet të jenë në përputhje me të drejtat e garantuara nga Neni 3.

Në 2007, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenin 3 në çështjen *Mammadov kundër Azerbajxhanit*. Sardor Jalaloglu Mammadov, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike të Azerbajxhanit (një nga partitë e opozitës që i konsideronin ilegjitime rezultatet e zgjedhjeve presidenciale të tetorit 2003) u arrestua dhe u mbajt nën arrest nga policia më 18 tetor 2003. Gjykata konstatoi se Z. Mammadov i ishte nënshtruar torturës ndërsa mbahej nën arrest dhe se autoritetet nuk kishin kryer një investigim të plotë mbi pretendimet e tij për ushtrim torture.

... ekstradimit dhe dëbimit: Gjykata mund të konstatojë se ka pasur shkelje të Nenin 3 nëse ekstradimi apo dëbimi i një individi në një shtet tjetër mund të përbëjë një rrezik real pasi mund t'i nështrohet edhe keqtrajtimin.

Në 2008, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenin 3 në çështjen *Saadi kundër Italisë*. Çështja kishte të bënte me dëbimin e mundshëm të Nassim Saadit në Tunizi, kur pretendoi se ishte dënuar në vitin 2005, në mungesë të tij deri në 20 vjet burgim për anëtarësim në një organizatë terroriste që vepronte jashtë shtetit në kohë paqeje dhe për nxitje të terrorizmit. Gjykata u shpreh se nëse vendimi për të dëbuar kërkuesin në Tunizi do të zbatohet, do të konstatohej shkelje e Nenin 3.





Neni 4 i Konventës ndalon skllavërinë, robërinë dhe punën e detyruar apo me dhunë. Kjo mbulon edhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Shteteve gjithashtu u kërkohet të kenë legjislacion në fuqi që garanton mbrojtje praktike dhe efektive kundrejt këtyre akteve.



Neni 4:

Ndalohet të trajtoheni si skllavër apo t'ju detyrojnë të kryeni punë të detyruar.

ndalimi i

skllavërisë dhe punës së detyruar

NË PRAKTIKË, *ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar përfshin...*

... mbrojtjen e të punësuarve vendas: shtetet duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të mbrojtur individët kundrejt skllavërisë në vendet e tyre.

Në 2005, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenet 4 në çështjen *Siliadin kundër Francës*. Siwa-Akofa Siliadin u ankimua se e drejta penale franceze nuk i kishte ofruar asaj mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër "robërisë" të cilës ajo i ishte nënshtruar, ose minimalisht kundër punës "së detyruar e forcërisht" që ishte

detyruar të kryente, gjë që në fakt e kishin shndërruar atë në një skllave në vendin e vet. Gjykata konsideroi se legjislacioni penal francez në fuqi në kohën në fjalë nuk i kishte siguruar kërkueses mbrojtje specifike e efektive kundrejt veprimeve ndaj të cilave ajo kishte rënë viktimë.

... veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore: kishte pasur shkelje të Nenet 4 në çështjen *Ranstsev kundër Qipros dhe Federatës Ruse*, duke u mbështetur në faktin se autoritetet qipriote dhe ruse kishin dështuar në mbrojtjen e një artisti rus kabaresh 20-vjeçar kundrejt trafikimit human. Ky ishte i pari vendim i Gjykatës që kishte të bënte me trafikimin e qenieve njerëzore.



Neni 5:

*Nëse arrestoheni,
keni të drejtën të
dini arsyen pse.
Nëse arrestoheni
keni të drejtën të
çoheni përpara një
gjykatë brenda një
kohe të caktuar, ose
të liroheni derisa të
kryhet gjyqi.*

Neni 5 i Konventës ofron një mjet për të verifikuar nëse mbajtja nën arrest është e ligjshme apo jo, e kështu pra, për të mbrojtur njerëzit kundrejt arrestimit dhe burgimit arbitrar.

Shteteve gjithashtu u kërkohet tu sigurojnë personave të ndaluar një numër garancish procedurale: çdokush i arrestuar duhet të informohet sa më shpejt të jetë e mundur mbi arsyet e arrestimit dhe duhet të paraqitet sa më shpejt përpara një gjyqtari apo të lirohet deri në gjykim. Gjithashtu, çdokush, arrestimi apo ndalimi i të cilit bie në kundërshtim me të drejtat e garantuara nga Neni 5, ka të drejtë për kompensim.

E drejta për *liri* dhe *siguri*

NË PRAKTIKË, *e drejta për liri dhe siguri zbatohet për shembull për...*

... ndalimin e paligjshëm: Konventa mbron individët kundrejt individëve ndaj burgimit arbitrar e të paligjshëm.

Në 2004, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 5 në çështjen *Frommelt kundër Lihtenshtejnit*. Peter Frommelt u mbajt në burgim në 1997 me dyshimin e kryerjes së veprave penale duke përfshirë përvetësim e mashtrim. Ai pretendoi se kishte pasur të meta procedurale në rishqyrtimin e situatës së tij të paraburgimit.

... burgimin e paligjshëm: Në prill 2004, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të Nenit 5 në çështjen *Assanidze kundër Gjeorgjisë*. Tengiz Assanidze kishte qenë ish-kryetari i Batumit dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Republikës Autonome Ajariane. Kërkuesi ishte mbajtur në burgim për më shumë se tre vjet pas shfajsimit të tij nga Gjykata e Lartë e Gjeorgjisë në 2001. Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte mbajtur nën burgim në mënyrë arbitrare dhe u shpreh se shteti gjeorgjian duhet të siguronte lirimin e tij në një datë sa më të shpejtë të mundshme. Ky vendim ishte i pari ku Gjykata urdhëronte një shtet të lironte kërkuesin sa më shpejt të jetë e mundur.



Neni 8 i Konventës mbrohet të drejtën për të respektuar jetën private e familjare, banesën e korrespondencën.

Shteti nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të një individit; në të njëjtën kohë, ka detyrimin për të mbrojtur integritetin moral dhe fizik të gjithsecilit.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka dhënë mbrojtjes së "jetës private e familjare" një interpretim mjaft të gjerë, duke mbajtur këndvështrimin se dëbimi i një të huaji, ndalimi i akteve private homoseksuale me konsensus, refuzimi nga një shtet për të lejuar një të ndaluar të ndjekë funeralin e një anëtarit të familjes, apo refuzimi nga një shtet për të njohur atësinë e vërtetë të një foshnjeje në lindje, përbëjnë të gjitha shkelje të Nenit 8.



Neni 8:

Ju keni të drejtën për jetën tuaj private e familjare, banesën dhe korrespondencën.

E drejta për të respektuar *jetën private e familjare*

NË PRAKTIKË, *e drejta për respektimin e jetës private e familjare zbatohet për shembull për...*

... botimet që ndërhyjnë në jetën private të individit: njerëzit e famshëm dhe pjesëtarët e familjeve mbretërore mbështeten në Nenin 8 për të mbrojtur privatësinë e tyre nga ndërhyrja e medias.

Në 2004, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të Nenit 8 në çështjen *von Hannover kundër Gjermanisë*. Princesha Karolina von Hannover në shumë raste kishte kërkuar pa sukses në gjykatat gjermane për një vendim gjyqësor që të ndalonte të tjera botime të një serie fotografish që ishin shfaqur në revistat gjermane në vitet 1990, me pretendimin se ato cënonin të drejtën e saj për të mbrojtur jetën e saj private e për të kontrolluar përdorimin e imazhit të saj. Gjykata tha se çdokush, përfshirë njerëzit e njohur për publikun, duhet të kenë një "pritshmëri legjitime" që jeta e tij ose e saj private të mbrohet.

... kujdestarinë e një fëmije pas divorcit: shtetet duhet të marrin masat e nevojshme për të zbatuar vendimin e një gjykate për të siguruar një marrëdhënie të ngushtë midis prindërve dhe fëmijëve.

Në 2006, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 8 në çështjen *Bajrami kundër Shqipërisë*. Bajrami u ankua se e kishte pasur të pamundur të siguronte zbatimin e një vendimi gjyqësor që i jepte kujdestarinë e vajzës që ish-gruaja e tij e kishte marrë me vete në Greqi pas divorcit të tyre. Pasi kishte ritheksuar faktin se Konventa u kërkonte Shteteve të ndërmerrnin të gjitha masat e nevojshme për të ribashkuar prindërit dhe fëmijët e tyre në ekzekutimin e një vendim përfundimtar të një gjykate vendase, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të të drejtës së kërkuarit për të respektuar jetën e tij familjare.

Neni 9 mbron lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë të çdokujt; këto të drejta janë të padhunueshme, ashtu siç është edhe e drejta për të ndryshuar fenë apo besimin. Të gjitha sistemet e njohura të besimit mbrohen nën Nenin 9.



Neni 9:

Ju keni të drejtën për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

NË PRAKTIKË, *e drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, përfshin...*

... të drejtën për të praktikuar fenë e vet **lirshëm**: Shtetet duhet ta respektojnë këtë të drejtë që mbrohet nga Neni 9.

Në 1993, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 9 në çështjen *Kokkinakis kundër Greqisë*. Minos Kokkinakis, një Dëshmitar i Jehovahit, u arrestua më shumë se 60 herë për kthimin e fesë.

... **neutralitetin e një shteti**: shtetet nuk duhet të ndërhyjnë në çështjet e brendshme të një komuniteti fetar.

Në 2000, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 9 në çështjen *Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë*. Kërkuesit, një ish-Kryetar Myfti i fesë Muslimane bullgare dhe një mësues i fesë islame, u ankimuan për vendimin e autoriteteve bullgare në ndërrimin e drejtimit dhe statutit të komunitetit musliman. Gjykata konstatoi se ka pasur ndërhyrje me organizimin e brendshëm të komunitetit musliman dhe lirisë së fesë së kërkuesve.





Neni 10:

Ju keni të drejtën për të shprehur e shkruar në mënyrë të përgjegjshme atë që mendoni e për të dhënë e marrë informacion nga të tjerët. Kjo përfshin edhe lirinë e shtypit.

Neni 10 i Konventës mbron lirinë e shprehjes, si një nga themelet kyçe të një shoqërie demokratike.

Media kërkon mbrojtje të veçantë, pasi luan një rol kyç në mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Ky nen mbron të drejtën për të kritikuar, për të nxjerrë supozime, apo vlerësuar vendime dhe të drejtën për të dhënë opinione.

Liria e Shprehjes

NË PRAKTIKË, e drejta për lirinë e shprehjes përfshin...

... lirinë e shtypit dhe transmetimit në media: nuk mund të ketë shoqëri demokratike pa një shtyp të lirë e të shumëllojshëm. Liria e shprehjes e garantuar nga Neni 10 është e zbatueshme edhe për informacionin apo idetë që ofendojnë, shokojnë apo shqetësojnë shtetin apo ndonjë sektor tjetër të popullsisë. Shtetet kanë detyrimin për të siguruar këtë të drejtë.

Në 2008, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 10 në çështjen *Lopes Gomes da Silva kundër Portugalisë*. Vicente Jorge Lopes Gomes da Silva, i cili në kohën në fjalë ishte menaxher i një gazete të përditshme Público, u dënua për shpifje. Gjykata deklaroi në veçanti se liria e shprehjes ishte e një rëndësie të veçantë për sa i përket shtypit e limitet e kritikizmit të pranueshëm janë më të gjera në lidhje me një politikan që vepron në funksionin e tij publik.

Nga ana tjetër, në 2009 në çështjen *Times Newspapers Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 1 dhe 2), Gjykata përfundoi se dënimi i gazetës për shkak të botimit të artikujve me përmbajtje shpifje të arkivuara në internet nuk përbënte shkelje të Konventës.

... lirinë e shprehjes së nëpunësve civil: Konventa mbron nëpunësit civil kundrejt kufizimeve të lirisë së shprehjes në funksion të detyrimit të tyre për besnikëri në vendin e punës, përveç rasteve të veçanta.

Në 1995, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 10 në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë*. Kërkuësja mbrojti faktin se përjashtimi i saj nga shërbimi civil për shkak të veprimtarisë së saj politike, si anëtare e Partisë Komuniste Gjermane, kishte shkelur të drejtën e saj për lirinë e shprehjes. Gjykata vendosi se shkarkimi i saj ishte një dënim joproporcional.



Neni 11:

Ju keni të drejtën për të marrë pjesë në takime paqësore e për të krijuar apo për të aderuar në shoqata – duke përfshirë sindikatat

Neni 11 mbron të drejtën e individit për tu organizuar e për të marrë pjesë në takime e demonstrata paqësore e për të garantuar të drejtën për të formuar apo aderuar në shoqata dhe sindikata.

Shtetet kanë detyrimin për të ndërmarrë hapat e duhura për të mbrojtur demonstratat e ligjshme e paqësore; rregullat që parashikojnë demonstratat në vende publike nuk duhet tu ndërrojnë mendjen qytetarëve nga ushtrimi i të drejtës së tyre për lirinë e tubimit paqësor.

Liria e tubimit dhe organizimit

NË PRAKTIKË,
e drejta për lirinë e tubimit dhe
organizimit përfshin...

... të drejtën për të krijuar një shoqatë: shtetet duhet të garantojnë këtë të drejtë që mbrohet nga Neni 11.

Në 2007, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 11 në çështjen *Ramazanov* dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit. Kërkuesit krijuan një shoqatë të quajtur “Asistencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut të të Pastrehëve dhe Qytetarëve Vulnerabël të Bakusë” dhe aplikuan disa herë tek autoritetet që të regjistronin organizatën. Gjykata konsideroi se vonesat e konsiderueshme në regjistrimin e një shoqate, që cënonin afatat statutore, përbënin shkelje të së drejtës së kërkuesve për lirinë e organizimit.

... lirinë për tubim paqësor në vende publike (demonstrata): shtetet duhet të garantojnë lirinë e tubimit paqësor. Me qëllim që të sigurohet rendi publik, autorizimi i marrë nga autoritetet publike është i ligjshëm, nëse parashikohet me ligj.

Në 2007, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 11 në çështjen *Mkrtyan kundër Armenisë*. Armen Mkrtyan u detyrua të paguante një gjobë se kishte marrë pjesë në një demonstratë në maj 2002. Duke vëzhguar se në periudhën në fjalë nuk ka pasur legjislacion në Armeni që drejtonte organizimin e demonstratave, Gjykata doli në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për lirinë e tubimit paqësor ende nuk ishte parashikuar me ligj.



Neni 14:

Ju keni këto të drejta pa asnjë dallim bazuar në shkaqe të tilla si ngjyra, gjinia, gjuha, besimi politik apo fetar, apo origjina



Neni 1 i

Protokollit Nr. 12
Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit:

Ju nuk mund të diskriminoheni nga autoritetet publike bazuar në shkaqe të tilla si ngjyra, gjinia, gjuha, besimi politik apo fetar, ose origjina.

Ndalimi i diskriminimit është një pjesë kyçe e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Është i lidhur ngushtë me parimin e barazisë që parashikon se të gjithë njerëzit kanë lindur e mbeten të lirë e të barabartë në dinjitet e të drejta.”

Ndalimi i diskriminimit konstatohet në të gjithë instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ndalimi i Diskriminimit

NË PRAKTIKË, *ndalimi i diskriminimit zbatohet për shembull për...*

... **diskriminimin bazuar në orientimin seksual:** shtetet duhet të garantojnë që njerëzit trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual.

Në 2003, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 14 në çështjen *Karner kundër Austrisë*. Siegmund Karner u ankimua në lidhje me vendimin e gjykatave austriake përse i përket të drejtës statutoare të një anëtarit të një familjeje për të marrë me qera nuk zbatohet për çiftet homoseksuale.

... **diskriminimin bazuar në origjinë:** shtetet duhet të garantojnë trajtim të barabartë pavarësisht nga origjina e individit.

Në 2007, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 14 në çështjen *D.H. kundër Republikës Çeke* në të cilën fëmijët romë ishin vendosur në shkolla të posaçme për ta.

... **diskriminimin bazuar në prejardhje:** shtetet duhet të garantojnë parimin e barazisë në çështje që kanë lidhje me prejardhjen, veçanërisht në lidhje me trashëgiminë.

Në 2004, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Nenit 14 në çështjen *Pla dhe Puncernau kundër Andoras*. Çështja kishte të bënte me vendimet e gjykatës që Antoni Pla Puncernau, si fëmijë i adoptuar, nuk mund të trashëgonte pronat e së ëmës pasi nuk mund të konsiderohej si “fëmijë lindur nga një martesë legjitime dhe e pranuar nga kisha” siç parashikohej në testamentin e së ëmës.



Përjasja:

këto veprimtari kërkojnë punë kërkimore dhe mund të jepen si detyrë shtëpie apo detyra me gojë që mund të përgatiten në shtëpi.



Vendi im dhe KEDNJ-ja

TË VENDOSIM TË DREJTAT E NJERIUT NË KONTEKSTIN E TYRE HISTORIK

Çdo vend ka historinë e vet të të drejtave të njeriut: në Hungari, për shembull, pati kryengritje të bujkrobërve (1514-1710) që arriti kulmin në vitin 1848 me legjislacionin që nxirrte jashtë ligjit robërinë dhe prezantonte lirinë e shtypit. Duke u kthyer edhe më para në kohë në vitin 1215 në Angli, Magna Karta përdori mjete kushtetuese për të kufizuar shfrytëzimin tiran të pushtetit mbretëror. Më herët në Evropë, ka shumë shembuj të lëvizjeve që bënin fushata për lirinë dhe të drejtat e njeriut.

▀ Ndajini nxënësit në grupe dhe kërkojuni të analizojnë njerëzit, publikimet, artin, evenimentet dhe lëvizjet që kontribuan në zhvillimin e të drejtave të njeriut në vendin tuaj. Një ose më shumë grupeve mund tu kërkohej të analizojnë ndikimet nga vende të tjera.

Rezultatet mund të përdoren në shumë mënyra:

- ◆ secili grup mund të prezantojë rezultatet e nxjerra pjesës tjetër të klasës
- ◆ disa nxënës mund të shkruajnë një ese mbi aspekte të punës së tyre hulumtuese në grupin e punës ku ishin përfshirë.

▀ Organizoni një ekspozitë për të drejtat e njeriut në klasë me qëllim që t'i shohin edhe klasat e tjera.

ORGANIZATAT QË MBROJNË TË DREJTAT E NJERIUT

Ne të gjithë jemi përgjegjës për të siguruar që të drejtat e njeriut të mbrohen e promovohen. Megjithatë shtetet angazhohen të mbrojnë të drejtat e njeriut, shumë organizata jo-qeveritare (OJF) janë aktive nëpër të gjithë Evropën dhe botën për të promovuar, zhvilluar e mbrojtur të drejtat e njeriut.

▀ Kërkojuni nxënësve që të gjejnë se cilat OJF janë aktive në këtë fushë në vendin tuaj.

Cilat janë synimet e tyre? Çfarë pune bëjnë? Çfarë anëtarësie kanë? A ka organizata aktive të të drejtave të njeriut në rajonin tuaj? Do të ishte e mundur të ftonit një OJF që punon për të drejtat e njeriut për të mbajtur një prezantim në klasë?

Hulumtime dhe analiza



ANGAZHIME NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

▀ Vëzhgoni lidhjet ndërmjet të drejtave të njeriut në vendin tuaj dhe organizatave ndërkombëtare.

Duke punuar në grupe, nxënësve u kërkohet të hulumtojnë për temat e mëposhtme:

- ◆ Kur dhe pse u bë vendi juaj anëtar i Këshillit të Evropës?
- ◆ Kur e ka nënshkruar e ratifikuar vendi juaj Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe cilët protokolle ka ratifikuar?
- ◆ Cili është dallimi kryesor midis Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut e KEDNJ-së?
- ◆ Kur e ka nënshkruar vendi juaj Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut?
- ◆ Kur dhe pse u bë anëtar i Kombeve të Bashkuara vendi juaj?
- ◆ A ka nënshkruar vendi juaj dokumente të tjera madhore të Kombeve të Bashkuara me fokus të drejtat e njeriut?
- ◆ Çfarë angazhimesh të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ka pranuar vendi juaj?

VENDI JUAJ DHE KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

▀ Cilat janë efektet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që janë në fuqi në vendin tuaj? Kur një shtet ratifikon KEDNJ-në, pasojat janë afatgjata. Edhe në këtë rast, nxënësve u kërkohet të hulumtojnë mbi temat e mëposhtme:

- ◆ Cilat institucione ndikohen nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

- ◆ Cilat institucione janë përgjegjëse për të siguruar që individët në vend të gëzojnë të drejtat dhe liritë e garantuara nga Konventa?
- ◆ A është e mundur të organizoni një vizitë si klasë në një nga këto institucione?
- ◆ Cilat nga dispozitat në kushtetutën e vendit tuaj janë të ngjashme me të drejtat e parashtruara në Konventë?
- ◆ Si quhet gjyqtari nga vendi juaj që qëndron në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe cili është historiku i karrierës së tij/saj profesionale?
- ◆ A ka pasur çështje nga vendi juaj që janë paraqitur në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut? Nëse po, cilat ishin rezultatet?
- ◆ Çfarë masash ka marrë vendi juaj për të qenë në përputhje me Konventën, kur është konstatuar një shkelje?

▀ Ka edhe disa konventa e mekanizma të tjera të Këshillit të Evropës që mbrojnë të drejtat e njeriut. Çfarë lidhjeje ka ndërmjet vendit tuaj dhe:

- ◆ Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?
- ◆ Kartës Sociale Evropiane?
- ◆ Konventës për Mbrojtjen kundrejt Torturës?
- ◆ Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare?
- ◆ Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës?

Rast Studimor – Analiza dhe aplikimi i asaj që kemi mësuar deri tani



Kohëzgjatja:

30 minuta (për të lexuar rastin studimor e për t'iu përgjigjur pyetjes) plus 20 minuta (korrigjim, mundësisht duke vazhduar me një diskutim mbi çështjet e trajtuara).

Përqsaja:

ndajini nxënësit në grupe të vogla (4-5). Kërkoni të lexojnë rastin studimor e më pas tu përgjigjen pyetjeve me ndihmën e materialeve informative. Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues për të bërë një prezantim të shkurtër me përgjigjet.



Mary Williams *dhe imazhi i saj në shtyp*

Mary Williams është aktore me famë botërore. Në vitin 2001, revista Star News botoi një sërë artikujsh të cilët ishin kritikë ndaj performancës së saj në filmin e saj më të fundit.

Zj Williams hodhi një gjyq revistën për shpifje. Ajo i kritikoi vetë artikujt, si dhe fotot që revista kishte botuar për të, me pretendimin se kishte ndërhyrje në privatësinë e saj.

Gjykatat në vendin e saj (shtet anëtar i Këshillit të Evropës) konstatuan se artikujt në fakt përmbanin vërejtje shpifëse për të dhe urdhëruan revistën të paguante një gjobë prej 7.000 eurosh. Gjithsesi, po të njëjtat gjykata vërejtën se Zj. Williams, si personazh i famshëm, duhet të përgatitej për të pranuar botimin e fotove që portretizonin jetën e saj të përditshme.

Pyetje

▀ Mary Williams kërkoi të apelonte kundër vendimit të gjykatës për sa i përket botimit të fotografive.

A mund ta paraqesë ajo çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut? Nëse mundet, në cilin nen (apo nene) të Konventës duhet ta bazojë ajo kërkesën e saj?

▀ Revista Star News kërkon të apelojë kundër vënies së gjobës për të cilën duhet të paguajë.

A mund ta paraqesë çështjen në Gjykatën Evropiane? Nëse mundet, në cilin/cilat nen/nene të Konventës duhet të bazojë kërkesën?

▀ Shkruani rreth 20 rreshta për si vijon:

A ka limite për lirinë e shprehjes së gazetarëve?

Rast Studimor – Analiza dhe aplikimi i asaj që kemi mësuar deri tani



Kohëzgjatja:

30 minuta (për të lexuar rastin studimor e për t'iu përgjigjur pyetjeve) plus 20 minuta (korrigjim, mundësisht duke vazhduar me një diskutim mbi çështjet e trajtuara).

Përqasja:

ndajini nxënësit në grupe të vogla (4-5). Kërkoni të lexojnë rastin studimor e më pas tu përgjigjen pyetjeve me ndihmën e materialeve informative. Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues për të bërë një prezantim të shkurtër me përgjigjet.



Demostratat Paqësore

Një park i gjelbër i fundit i mbetur në qytet do të shndërrohet në një parkim makinash. Dhjetë qytetarë të zonës bënë një demonstratë paqësore në park, duke u shprehur se atyre u nevojitet një vend për tu qetësuar dhe për fëmijët e tyre që të mund të luajnë në të.

Policia mbërriti në vend dhe u tha se nuk u lejohet të bëjnë demonstratë e se duhet të largohen për në banesat e tyre. Demonstruesit u ulën përtokë dhe refuzuan të lëviznin. Policia i lëvizi me forcë duke lënduar disa prej tyre.

Pyetje:

- A janë cënuar të drejtat themelore të demonstruesve? Nëse po, cilat të drejta?
- A mund të bëjnë një kërkesë të përbashkët demonstruesit për ta paraqitur pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut? Thoni cilat janë kushtet që duhen përmbushur me qëllim që kërkesa të mund të paraqitet në Gjykatë.
- Mbi cilin/cilat nen/nene të Konventës mund të bazojnë ata kërkesën e tyre?

Rast Studimor – Analiza dhe zbatimi i asaj që kemi mësuar deri tani



Kohëzgjatja:

30 minuta (për të lexuar rastin studimor e për t'iu përgjigjur pyetjes) plus 20 minuta (korrigjim, mundësisht vijuar me diskutime për çështjet e temat e trajtuara).

Përfaqësja:

ndani nxënësit në grupe të vogla (4-5). Kërkoni të lexojnë rastin studimor si më poshtë e më pas përgjigjuni pyetjeve me ndihmën e materialeve informuese. Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues që të japë një prezantim të shkurtër të përgjigjeve.



Lorenzo

Divorci i tij dhe fëmijët e tij

Lorenzo kërkon divorcin pas 12 vjet martesë. Bashkëshortja e tij nuk pati kundërshtime, por gjykatës iu deshën disa vite derisa doli vendimi i gjykatës.

Lorenzo kërkon të mbajë kontaktet me dy fëmijët e tij, por ligji në vend nuk e lejon derisa të përfundojnë procedurat e divorcit.

Pyetje

- Në cilin nen të Konventës duhet të mbështetet Lorenzo për të për të paraqitur ankimmimin rreth situatës së tij?
- Përkruani fazat e ndryshme të një kërkesë pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtat e Njeriut, të cilën Lorenzo duhet ta paraqesë aty.

Rast Studimor – Analiza dhe zbatimi i asaj që kemi mësuar deri tani



Kohëzgjatja:

30 minuta (për të lexuar rastin studimor e për t'iu përgjigjur pyetjeve) plus 20 minuta (korrigjim, mundësisht vijuar me diskutime për çështjet e temat e trajtuara).

Përfaqësja:

ndani nxënësit në grupe të vogla (4-5). Kërkoni të lexojnë rastin studimor si më poshtë e më pas përgjigjuni pyetjeve me ndihmën e materialeve informuese. Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues që të japë një prezantim të shkurtër të përgjigjeve.



Roberto dhe *Burgimi*

Në vitin 1996, Roberto u dënua me 20 vjet burg për një numër vjedhjesh dhe rrëmbim makinash. Ai u mbajt në paraburgim për gjashtë muaj përpara se të transferohej në burg për të vuajtur dënimin kur vendimi i gjykatës u bë përfundimtar.

Roberto ankimohet se mbajtja e tij në paraburgim ishte e paligjshme. Gjithashtu, ai kritikoi kushtet në të cilat ishte mbajtur, të cilat ai i quan degraduese. Ai gjithashtu pretendon se korrespondenca e tij ishte hapur dhe lexuar nga autoritetet e burgut përpara se t'ua kalonin atij.

Pyetje:

- ▀ A janë cënuar të drejtat themelore të Robertos? Nëse po, cilat të drejta?
- ▀ Në cilat nene të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të mbështetet Roberto për të paraqitur ankimin rreth situatës së tij?
- ▀ Cila kritereve duhet t'u referohet avokati i Robertos për të marrë nën shqyrtim kushtet e paraburgimit të klientit?

Rast Studimor – Analiza dhe zbatimi i asaj që kemi mësuar deri tani



Kohëzgjatja:

30 minuta (për të lexuar rastin studimor e për t'iu përgjigjur pyetjes) plus 20 minuta (korrigjim, mundësisht vijuar me diskutime për çështjet e temat e trajtuara).

Përfaqësja:

ndani nxënësit në grupe të vogla (4-5). Kërkoni të lexojnë rastin studimor si më poshtë e më pas përgjigjuni pyetjeve me ndihmën e materialeve informuese. Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues që të japë një prezantim të shkurtër të përgjigjeve.



Ivani dhe perspektiva e *dëbimit të tij*

Ivani u arrestua nga policia në një vend fqinj (një shtet anëtar i Këshillit të Evropës). Duke qenë se dokumentet e tij nuk ishin në rregull, gjykatat vendosën që ai duhet të dëbohej në vendin e tij të origjinës.

Ivani po përpiqet të apelojë kundër këtij vendimi.

Ai pretendon se ai i përket një pakice etnike që diskriminohet në vendin e tij të origjinës dhe se, nëse ai kthehet aty, me shumë mundësi mund të torturohet – apo madje edhe të vritet – qoftë nga autoritetet zyrtare, qoftë nga rebelët.

Pyetje

■ A mund të paraqesë Ivani kërkesë pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kundër vendit fqinj me ankesë ndaj vendimit të kthimit të tij në vendin e origjinës? Në cilin/cilat nen/nene të Konventës mund të bazojë ai kërkesën e tij?

■ Në ç'bazë e masë mund të paraqesë ai një kërkesë kundër vendit të tij të origjinës?

Rast Studimor – Shkëmbimi i ideve,
të diskutojmë mbi të drejtat e njeriut



Kohëzgjatja:

1 – 1½ hours.

Përfaqsjë:

ndani klasën në grupe me 5 apo 6 vetë dhe lexojuni atyre
skenarin e mëposhtëm.

Më pas, filloni diskutimin duke përdorur pyetjet e dhëna më
poshtë.



Vendi Imagjinar

***“Imagjinoni sikur keni zbuluar një
vend të ri ku askush nuk ka jetuar
më parë, dhe ku nuk ka ligje apo
rregulla. Ju dhe pjesëtarët e tjerë të
grupit do të jeni banorët në këtë tokë
të re. Ju nuk e dini se çfarë statusi do
të keni në këtë tokë të re.”***

▀ Individualisht, secili nxënës duhet të shkruajë një
listë me tre të drejta që ata mendojnë se duhet të
garantohen për cilindo në këtë vend të ri.

Kërkojuni nxënësve të ndajnë e diskutojnë listat e
hartuara brenda grupit të tyre. Grupi më pas duhet të
bjerë dakord për një listë prej 10 të drejtash të cilat ata
mendojnë se janë të rëndësishme. Grupi pastaj duhet të
shpikë një emër për vendin e ta shkruajë atë mbi një letër
të madhe së bashku me listën e të drejtave.

▀ Secili grup i paraqet listën e vet pjesës tjetër të klasës.

Ndërsa paraqesin si më sipër, shënoni secilën të drejtë
në fletën e madhe të të drejtave për të gjithë klasën ku
është shkruar si më sipër emri i vendit imagjinar; nëse të
drejtat përsëriten, vendosni një kryq pranë tyre. Pasi të
gjitha grupet të kenë bërë prezantimet e tyre, kërkojuni

klasës të identifikojnë të drejtat që mbivendosin apo
kundërshtojnë njëra tjetrën:

- ◆ A mund të racionalizohet lista me të drejta e të gjithë
klasës? A mund të grupohen së bashku të drejtat që janë
të ngjashme me njëra tjetrën?
- ◆ Sa afër realitetit është kjo listë?

▀ Mund të bëhen të tjera pyetje për temat e
mëposhtme:

- ◆ Cilat ide tuajat për cilat të drejta përbënin ndryshimin
më të rëndësishëm gjatë aktivitetit?
- ◆ A ka të drejta që nuk do të donit t'i shtonit në listë?
- ◆ A ka të drejta universale të njeriut?
- ◆ A ka organizata aktive të të drejtave të njeriut në rajonin
tuaj?
- ◆ Cilat janë synimet e tyre? Çfarë bëjnë ato? Cilët janë
anëtarët e tyre?

Quiz!

Kontrolloni se sa njohuri keni

1. Kur u adoptua KEDNJ-ja?

- ◆ 1948
- ◆ 1950
- ◆ 1959

2. Sa gjyqtarë ka për secilin vend?

- ◆ një
- ◆ varet nga vendi
- ◆ varet nga çështja

3. Kush mund të paraqesë një çështje në Gjykatë?

- ◆ shtetasit e Bashkimit Evropian
- ◆ shtetasit e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës
- ◆ çdokush, pavarësisht nga kombësia

4. Cili është afati kohor që duhet zbatuar për të paraqitur një çështje në Gjykatë pasi janë shterruar të gjitha mjetet e brendshme në gjykatat vendase?

- ◆ brenda 6 muajsh nga vendimi i fundit i gjykatës vendase
- ◆ brenda 10 vjetësh bazuar në faktet e çështjes
- ◆ në vitin vijues që nga vendimi i fundit i gjykatës vendase

5. Cili organ është përgjegjës për të monitoruar zbatimin e vendimeve të Gjykatës?

- ◆ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- ◆ Komisioneri për të Drejtat e Njeriut
- ◆ Komiteti i Ministrave

6. Cili shtet nuk e ka nënshkruar e ratifikuar ende KEDNJ-në?

- ◆ Turqia
- ◆ Bjellorusia
- ◆ Zvicra

7. Për cilat nga fushat e mëposhtme Gjykata ka dhënë vendime?

- ◆ mbrojtja kombëtare
- ◆ rreziku i ndotjes kimike
- ◆ bioetika

8. Sa vende të Bashkimit Evropian nuk janë palë e KEDNJ-së?

- ◆ 0
- ◆ 1
- ◆ 9

9. Kush është përgjegjës për ekzekutimin e një vendimi që ka konstatuar shkelje të Konventës?

- ◆ Shtetet
- ◆ Komiteti i Ministrave
- ◆ Gjykata

10. Në sa gjuhë të ndryshme mund të paraqitet një kërkesë në Gjykatë?

- ◆ 2
- ◆ 47
- ◆ Cilëndo nga gjuhët zyrtare të vendeve anëtare



- Përgjigjet e pyetjeve të **Kurjit**:
- 1) 1950
 - 2) një gjyqtar
 - 3) gdhokush, pavarësisht nga kombësia
 - 4) brenda 6 muajsh nga vendimi i fundit i gjykatës vendase
 - 5) Komiteti i Ministrave
 - 6) Bjellorusia
 - 7) reziku i ndotjes kimike
 - 8) 0
 - 9) shtetet
 - 10) cilindo nga gjyhet zyrtare të vendeve anëtare



Të tjerë dokumente të Këshillit të Evropës që mbrojnë të drejtat e njeriut

Me kalimin e viteve Këshilli i Evropës ka hartuar një sërë dokumentesh të tjera bazuar në të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

▀ Karta Sociale Evropiane

Karta Sociale Evropiane (1961), Protokolli i saj Shtesë (1988) dhe Karta e Rishikuar (1996) garantojnë një gamë të drejtash themelore sociale. Ato lidhen kryesisht me punësimin (për shembull, mos-diskriminimin, të drejtat e sindikatave, të drejtën për ndihmë sociale), mbrojtje kundrejt varfërisë dhe përjashtimit social, si dhe të drejtën për strehim të denjë.

▀ Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës

Në vitin 1987, Këshilli i Evropës adoptoi Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues ose Ndëshkimit. Kjo Konventë plotëson mbrojtjen e parashikuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke ngritur një Komitet Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT), të përbërë nga ekspertë të pavarur e të paanshëm, të cilët vizitojnë burgjet e shohin se si trajtohen të burgosurit.

▀ Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Ky është i pari instrument shumëpalësh e ligjërishit detyruar për të mbrojtur pakicat kombëtare në përgjithësi.

Konventa parashton parimet që duhen garantuar nga shtetet që e ratifikojnë atë. Këto përfshijnë barazinë përpara ligjit, marrjen e masave për të ruajtur e zhvilluar kulturat e për të ruajtur identitetet, fetë, gjuhët e pakicave dhe traditat.

▀ Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

ECRI u krijua në vitin 1993 për të forcuar luftën kundër të gjitha formave të racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit dhe intolerancës në nivel evropian. Ai vlerëson efektivitetin e masave të marra në nivel kombëtar e ndërkombëtar në këtë fushë dhe përkrah veprimin në të gjitha nivelet.

▀ Konventa për Veprimin kundër Trafikimit në Qeniet Njerëzore e Këshillit të Evropës

Konventa është një traktat gjithëpërfshirës që përqëndrohet kryesisht në mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ajo gjithashtu trajton ndalimin e trafikimit dhe ndjekjen penale të trafikantëve. Ajo është e zbatueshme pavarësisht se cilat janë viktimat, gra, burra apo fëmijë, cilatdo qofshin format e shfrytëzimit apo punës së detyruar apo robërisë, etj.

www.human-rights-convention.org

www.echr.coe.int

www.coe.int/socialcharter

www.cpt.coe.int

www.coe.int/monitoring

www.coe.int/ECRI

www.coe.int/commissioner

www.coe.int



www.human-rights-convention.org

Nëse dëshironi më tepër informacion, vizitoni faqet e mëposhtme të internetit për të drejtat e njeriut:

Këshilli i Evropës : www.coe.int

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: www.echr.coe.int

Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës: www.coe.int/execution